



Rishikohet mënyra e përfitimit nga skema e naftës, bashkitë pjesë e procesit të aplikimit për fermerët

Faqe 4



Ministri Salla: IPARD III do të hapet brenda 6 muajve, masa të reja edhe me Skemën Kombëtare

Faqe 4



Forcohet bashkëpunimi Doganë-AKU për garantimin e sigurisë ushqimore

Faqe 12



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit shkurt 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 528
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

KËRKESAT TEKNIKE, CERTIFIKIMI DHE GJURMUESHMËRIA SI ÇELËS PËR AKSES TË QËNDRUESHËM NË TREGUN ORGANIK TË BE-SË PËR SEKTORIN BAM SHQIPTAR

PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET E BE-SË DHE KËRKESAT GLOBALE PËR PRODHIMET ORGANIKE DHE SEKTORIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BAM)

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GOSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

GOSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Projekti për klimën dhe bujqësinë sërish "notë" negative, BB: Ka vonesa të theksuara në afate

Faqe 6



FINANCIM

Garancia sovrane për kreditimin e fermerëve u shfrytëzua vetëm në masën 12%

Faqe 12



BKFSH

Të mbrohemi në maksimum nga rreziku i përmbytjeve në bujqësi



Faqe 7

ANALIZË

Kina kultivon më shumë tokë bujqësore me standarde të larta në vitin 2025 mes shtytjes së modernizimit

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- Skemat mbështetëse në bujqësi: Grupimi në shoqata rrit përfitimet për fermerët Fq.2
- Salla në Greqi: Forcimi i bashkëpunimit në bujqësi Fq.2
- Eksportet e fruta-perimeve arritën mbi 330 mijë tonë, shtatë laboratorë për sigurinë ushqimore Fq.4
- Furrat e bukës pa furrxhinj, Shoqata e Prodhuesve letër Ibrahimajt: Subvenciononi fuqinë punëtore Fq.5
- Buzaishta, fshati që nuk u braktis - Uji dhe kultivimi i patates kanë frenuar braktisjen në zonën e Mokrës Fq.5
- Kalendari bujqësor, muaji mars 2026 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Salla në Greqi: Forcimi i bashkëpunimit në bujqësi

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla po zhvillon një vizitë në Greqi, që konsiderohet e rëndësishme për forcimin e lidhjeve dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e bujqësisë.

Objektivi kryesor i kësaj

mike dhe Hapjes dhe më vonë do të vizitohet Dhomën Tregtare të Profesionistëve të Athinës për një takim, ndër të tjera, me presidentin e institucionit, Janinis Hatzitheodosiou.

Po ashtu, ai zhvilloi takime me përfaqësues të komunitetit

sfida”, tha Salla.

Një tjetër çështje e rëndësishme që u diskutua gjatë vizitës ishte mbështetja që Shqipëria po kërkon nga Greqia për të përfunduar negociatat me Bashkimin Europian në lidhje me politikën bujqësore.

“Marrëdhëniet shqiptarogreke duhet të vazhdojnë të zhvillohen me frymë pozitive, të bazuara në interesat tona të përbashkëta strategjike, bashkëpunimin tonë të ngushtë në kuadër të NATO-s dhe perspektivën tonë evropiane”, theksoi ministri.

Salla theksoi se Bashkimi Europian do të luajë një rol kyç në rritjen e qëndrueshmërisë së bujqësisë shqiptare, dhe një mbështetje e fortë nga Greqia është e nevojshme për të përshpejtuar këtë proces.

Salla gjatë vizitës zyrtare në Athinë, u prit në një takim nga rektori i Universitetit Bujqësor të Athinës, prof. Spyridon Kintziosis, në një prej institucioneve më prestigjioze në rajon në fushën e arsimit dhe kërkimit bujqësor.

Në fokus të takimit ishte forcimi i bashkëpunimit akademik dhe kërkimor mes institucioneve dhe synimor ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme që lidhin arsimin universitar me zhvillimin praktik të sektorit bujqësor.

“Biseduam për krijimin e urave konkrete mes dy universiteteve përmes shkëmbimit të përvojave akademike, programeve të përbashkëta dhe thellimit të kërkimit shkencor”, theksoi ministri.

Gjatë vizitës, ministri Salla u njoh nga afër me infrastrukturën dhe kapacitetet kërkimore të universitetit, përfshirë laboratorët modernë dhe feramat eksperimentale, të cilat përbëjnë një model të integritetit të teorisë me praktikën dhe e bëjnë këtë institucion një pikë referimi në rajon.

Sipas tij, ky bashkëpunim hap perspektiva të reja për studentët, pedagogët dhe për zhvillimin e sektorit bujqësor në tërësi, duke forcuar lidhjen mes dijes akademike dhe nevojave reale të prodhimit.

Model i ri bashkëpunimi me gjashtë bashki për mbrojtjen e masiveve me gështenja

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla firmosi marrëveshjet e bashkëpunimit me bashkitë Shkodër, Tropojë, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz dhe Vau i Dejës, për zbatimin e programit të kontrollit biologjik të dëmtuesit të gështenjës.

Në ceremoni morën pjesë ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ervin Demo, si dhe përfaqësues të FAO-s.

Marrëveshja formalizon bashkëpunimin mes MBZHR-së dhe pushtetit vendor për zbatimin e projektit “Përmirësimi i prodhimit të qëndrueshëm të gështenjës në Shqipëri përmes kontrollit biologjik të insekteve dëmtuese”, duke përcaktuar kuadrin institucional për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij sektori.

“Po ndërtojmë një model të ri bashkëpunimi mes qeverisjes qendrore dhe pushtetit vendor për të mbrojtur një aset si masivet e gështenjës, që sot shtrihen në rreth 10 mijë hektarë dhe përbëjnë burim të rëndësishëm të ardhurash për zonat veriore”, u shpreh ministri Salla.

Masivet e gështenjës në veri të vendit po përballen me kërcënimin e grerëzës aziatike të gështenjës (Dryocosmus kuriphilus), një dëmtues që mund të shkaktojë humbje prodhimi.

Pas suksesit të pilotimit në Tropojë, ku u ngrit laborator

i parë fushor për rritjen e insekteve të dobishme që parazitajnë dëmtuesin, programi tashmë do të shtrihet në bashkitë e tjera me sipërfaqe të konsiderueshme gështenjash.

“Me zgjerimin e modelit të

një burim kryesor jetese.

Programi parashikon ngritjen e laboratorëve rajonalë për shumimin dhe shpërndarjen e agentëve biologjikë angazhimin e bashkive me ambiente dhe staf teknik për



vizite, siç shpjegon ministri në një intervistë për gazetën greke “Ta Nea”, është rritja e shkëmbimeve tregtare dhe thellimi i bashkëpunimit në fushën e bujqësisë, një sektor kyç për ekonominë e të dyja shteteve.

Vizita, vjen në një moment kur bujqësia shqiptare po synon të inkorporohet më thellë në tregun e përbashkët evropian.

Në këtë kontekst, ministri Salla thekson se Shqipëria është e angazhuar të përmirësojë politikën e saj bujqësore dhe t’i përshtatet rregullave dhe normave të Bashkimit Europian.

Në Athinë, Salla u takua me disa figura kyçe të politikës dhe biznesit grek.

Ai zhvilloi një takim të rëndësishëm me homologun e tij grek, ministrin e Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, Konstantinos Tsiasas, ku janë diskutuar mundësitë për rritjen e shkëmbimeve bujqësore midis dy vendeve.

Vizita vijoi me një ndalesë në Parlament për bisedime me kryetaren e Komisionit të Përhershëm të Prodhimit dhe Tregtisë, Fotini Arabatzi.

Menjëherë pas kësaj, ministri shqiptar i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të pritë në Ministrinë e Jashtme greke nga zëvendësministri i Jashtëm, Haris Theoharis, përgjegjës për çështjet e Diplomacisë Ekono-

shqiptar në Greqi dhe ka vizituar disa biznese shqiptare që operojnë në këtë vend.

Ministri Salla nënvizoi tre objektiva kryesore të kësaj vizite: së pari, forcimin e shkëmbimeve tregtare dypalëshe; së dyti, thellimin e bashkëpunimit institucional për harmonizimin me politikën e BE-së; dhe së treti, përfshirjen e ekspertizës greke në zbatimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PBB), që ka pasur një sukses të madh në Greqi.

Salla e konsideron këtë eksperiencë si një mundësi të shkëlqyer për të mësuar nga praktikatat e provuara të Greqisë, të cilat mund të aplikohet edhe në Shqipëri.

Në intervistën e tij për “Ta Nea”, Salla theksoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Ai nënvizoi se ndarja e përvojave dhe zhvillimi i zgjidhjeve të përbashkëta mund të luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e ujërave, bujqësinë e qëndrueshme dhe mbrojtjen e të ardhurave të fermerëve.

“Ndryshimet klimatike po bëhen gjithnjë e më të dukshme, dhe Greqia dhe Shqipëria, për shkak të afërsisë gjeografike dhe kushteve të ngjashme klimatike, mund të zhvillojnë strategji të përbashkëta për të luftuar këto



suksesshëm të Tropojës, duke luftuar në mënyrë biologjike dëmtuesin e grerëzës aziatike, synojmë të mbrojmë prodhimin, të forcojmë kapacitetet vendore dhe të garantojmë qëndrueshmëri afatgjatë për këtë sektor,” theksoi ai.

Kontrolli biologjik i aplikuar konsiderohet një zgjidhje miqësore me mjedisin dhe me kosto efektive, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në shëndetin e masiveve të gështenjës dhe në të ardhurat e fermerëve të vegjël, për të cilët grumbullimi dhe shitja e frutit përbën

monitorimin në terren, si dhe mbështetje teknike nga FAO përmes trajnimit të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë. Procesi synon rikuperim gradual të prodhimit, me rezultate të pritshme pas vitit të katërt dhe rikthim të plotë brenda 8–10 viteve nga ndërhyrja.

Ky bashkëpunim zhvillohet në kuadër të nisimës globale të FAO-s “Një vend, një produkt prioritar” (OCOP), që synon promovimin e produkteve bujqësore me vlerë strategjike dhe forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Vreshtaria, shtyllë e ekonomisë në Lunxhëri – Xhoxhi Kondi, 25 vite pasion

Vreshtaria mbetet një nga pasuritë bujqësore që vazhdon të mbajë gjallë ekonominë lokale në Lunxhëri. Kjo zonë

jo vetëm të ardhura, por edhe identitet për komunitetin.

Një ndër vreshtarët që i ka qëndruar besnik kësaj tradite

te spërkatja dhe mbrojtja nga sëmundjet gjatë verës. Sipas tij, çdo stinë ka rëndësinë e vet dhe çdo neglizhencë reflektohet drejtpërdrejt në cilësinë dhe prodhimin e rrushit.

“Afërsisht ne kemi 25 vite që merremi me vreshtari. Ka shumë punë vreshtaria, që nisim me krasitjen, lidhjet. Duhet bërë dhe spërkatja dimërore”- u shpreh fermeri Xhoxhi Kondi.

Ky aktivitet familjar ka nisur nga pasioni dhe vazhdon ende me të njëjtin përkushtim. Megjithatë, ai shpreh keqardhje që vreshtaria nuk po vazhdohet nga brezat e rinj, të cilët po largohen drejt qyteteve apo jashtë vendit.

Për më tepër, tregu i produkteve bujqësore po bëhet gjithnjë e më i vështirë, me konkurrencë të lartë dhe çmime jo gjithmonë të favorshme për prodhuesit vendas.

Pavarësisht sfidave, ai mbetet i bindur se vreshtaria është një pasuri që duhet ruajtur dhe zhvilluar, si një shtyllë e rëndësishme e ekonomisë dhe traditës së zonës.



njihet për traditën e saj të hershme në kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verës, duke qenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje.

Toka pjellore dhe klima e përshtatshme e kanë bërë vreshtarinë një aktivitet jetik, që brez pas brezi ka siguruar

është 69-vjeçari Xhoxhi Kondi nga fshati Nokovë.

Prej rreth 25 vitesh ai merret me frutikulturë, duke kultivuar rreth 6 dynym vreshta. Ai tregon se puna në vresht kërkon përkujdesje të vazhdueshme gjatë gjithë vitit që nga krasitja në dimër, lidhja dhe pastrimi i hardhive në pranverë, deri

Skemat mbështetëse në bujqësi: Grupimi në shoqata rrit përfitimet për fermerët

Ajencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër me specialistët e saj, ka marrë masat si me infrastrukturë, po ashtu edhe me burime njerëzore për të pritë fermerët sapo të hapen skemat mbështetëse për vitin 2026. Qëllim mbetet orientimi i fermerëve drejt bashkimit në shoqata

Përgjegjës i ekstensionit bujqësor Qarku Shkodër, Rifat

Kodra u shpreh për RTSH se, “Jemi në gatishmëri të plotë për të rifilluar aplikimet për vitin 2026 për subvencionet në bujqësi. Zgjedhja e vetme është bashkimi i fermerëve në shoqata me qëllim që të grupohen për prodhimin e tyre dhe të lidhen me kontrata qoftë Brenda vendit apo eksportimin në vendet e BE”

Vitin e shkuar skema më e

kërkuar ishte ajo e naftës pa akcizë ku kanë përfituar rreth 90% e aplikuesve. Në total janë rreth 5200 fermerë që janë mbështetur në një nga 9 skemat e ofruara

Skema Kombëtare 2026 për bujqësinë parashikon afro 20 milionë euro në formën e granteve dhe 31 milionë euro subvencione direkte për fermerët.

KËRKESAT TEKNIKE, CERTIFIKIMI DHE GJURMUESHMËRIA SI ÇELËS PËR AKSES TË QËNDRUESHËM NË TREGUN ORGANIK TË BE-SË PËR SEKTORIN BAM SHQIPTAR

PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET E BE-SË DHE KËRKESAT GLOBALE PËR PRODHIMET ORGANIKE DHE SEKTORIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BAM)

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare


Tregu i produkteve organike në Bashkimin Evropian paraqet një nga segmentet më dinamike dhe me rritje të qëndrueshme të konsumit ushqimor dhe jo-ushqimor. Pjesëmarrja e produkteve organike në shportën e konsumit varion nga rreth 1–6% në vendet e Evropës Jugore dhe Lindore, deri në nivele mbi 20–27% në vende si Danimarka, Zvicra dhe Austria. Kjo tendencë e qëndrueshme rritjeje krijon një dritare reale mundësisht për eksportuesit shqiptarë të bimëve mjekësore dhe aromatike, të cilët, falë biodiversitetit të pasur dhe praktikave tradicionale të mbledhjes dhe kultivimit, kanë potencial të konsiderueshëm për të furnizuar këtë treg me produkte me vlerë të shtuar.

Figura 1: Etiketa zyrtare organike për produktet organike në Evropë




Kuadri ligjor bazë që rregullon prodhimin organik në BE është Rregullorja (BE) 2018/848, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2022 dhe ka zëvendësuar skemën e mëparshme të ekuivalencës me një sistem përputhshmërie të plotë. Kjo do të thotë se operatorët nga vendet e treta, përfshirë Shqipërinë, duhet të respektojnë të njëjtat kërkesa teknike dhe procedurale si prodhuesit brenda BE-së. Rregullorja përcakton detyrime të qarta për regjistrimin e operatorëve, mbajtjen e regjistrave të detajuar të prodhimit, përdorimin e inpueteve të lejuara sipas listave pozitive të BE-së, si dhe respektimin e periudhës së konvertimit (zakonisht të paktën dy vite për kulturat shumëvjeçare dhe një cikël prodhimi për bimët njëvjeçare) përpara se produkti të mund të tregtohet si organik. Certifikimi duhet të kryhet nga trupa kontrolli dhe certifikimi të akredituar sipas ISO/IEC 17065 dhe të autorizuar për operim në vendet e treta.

Nga pikëpamja teknike, kërkesat për certifikimin organik përfshijnë ruajtjen dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës përmes rotacionit të kulturave, përdorimit të plehrave organike dhe praktikave agroekologjike, ndalimin e përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike sintetike, si dhe masa strikte për parandalimin e kontaminimit të kryqëzuar me produkte jo-organike gjatë prodhimit, përpunimit, magazinimit dhe transportit.




Operatorët duhet të zbatojnë sisteme të dokumentuara të gjurmueshmërisë, të mbajnë evidenca për çdo lot prodhimi dhe të jenë subjekt i inspektimeve të paktën një herë në vit, si dhe të inspektimeve të papritura bazuar në analizën e rrezikut.

Pas përmbushjes së të gjitha kërkesave, produktet mund të mbajnë logon zyrtare të BE-së për prodhimet organike, e cila është një tregues i drejtpërdrejtë i përputhshmërisë dhe besueshmërisë për konsumatorin evropian.



Një element kyç operacional për eksportet organike drejt BE-së është sistemi elektronik TRACES (Trade Control and Expert System), përmes të cilit lëshohet certifikata elektronike e inspektimit (e-COI). Çdo dërgesë produktesh organike duhet të shoqërohet me këtë certifikatë të gjeneruar dhe verifikuar në TRACES nga trupi certifikues dhe autoritetet kompetente. Pa një e-COI të vlefshme, mallrat nuk lejohen të hyjnë në territorin doganor të BE-së. Sistemi TRACES mundëson gjithashtu shkëmbimin e të dhënave në kohë reale ndërmjet autoriteteve të vendeve eksportuese dhe atyre të BE-së, duke rritur transparencën dhe kontrollin e zinxhirit të furnizimit.



Në Shqipëri, një nga sfidat kryesore historike ka qenë mungesa e pranisë lokale të organeve të certifikimit të akredituara ndërkombëtarisht, gjë që rriste kostot dhe kohën e procesit të certifikimit për NVM-të. Në vitet e fundit, kjo pengesë është adresuar përmes hapjes së degëve apo përfaqësive të trupave certifikues të BE-së dhe rritjes së kapaciteteve vendase për auditim dhe kontroll. Megjithatë, mbeten sfida të tjera teknike, si nevoja për më shumë laboratorë të akredituar sipas ISO/IEC 17025 për analiza të mbetjeve të pesticideve, metaleve të rënda dhe parametrave të cilësisë për produktet BAM, si dhe forcimi i sistemit të mbikëqyrjes së tregut dhe kontrollit zyrtar.

Përveç kërkesave ligjore të BE-së, blerësit ndërkombëtarë të produkteve BAM shpesh vendosin kërkesa shtesë private që lidhen me standardet e sigurisë ushqimore, qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale. Këto përfshijnë respektimin e kufijve maksimalë të mbetjeve (MRL) sipas legjislacionit të BE-së dhe kërkesave specifike të klientit, certifikime të kombinuara si Organic së bashku me ISO 9001, ISO 22000/FSSC 22000 ose BRCGS për përpunimin, si dhe skema të përgjegjësisë sociale si SMETA ose Fairtrade për kushtet e punës dhe transparencën në zinxhirin e furnizimit. Në sektorin e mbledhjes nga natyra, standarde si FairWild kërkojnë plane të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe monitorim të ndikimit në biodiversitet.

Në një perspektivë më të gjerë, përputhshmëria me standardet organike dhe të qëndrueshmërisë kontribuon drejtpërdrejt

në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, duke mbrojtur mjedisin, duke përmirësuar kushtet e punës në zonat rurale dhe duke rritur transparencën dhe besimin në zinxhirin e furnizimit. Për Shqipërinë, për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e sektorit BAM dhe të produkteve organike, është thelbësore forcimi i infrastrukturës kombëtare të cilësisë (standardizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut), mbështetja financiare dhe teknike e NVM-ve për procesin e certifikimit, rritja e kapaciteteve të kontrollit dhe inspektimit, si dhe harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së. Në këtë mënyrë, përputhshmëria me standardet nuk mbetet vetëm një kusht për eksport, por shndërrohet në një investim strategjik për modernizimin dhe zhvillimin afatgjatë të sektorit agro-ushqimor shqiptar.



Ministri Salla: IPARD III do të hapet brenda 6 muajve, masa të reja edhe me Skemën Kombëtare

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, në një konferencë për mediat njoftoi zbatimin e një sërë masash të reja që pritet të nisnin në mbështetje të sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë, përmes Skemës Kombëtare me një vlerë prej 5,2 miliardë lekësh, si dhe përmes masave mbështetëse që do të financohen nga fondet e programit IPARD III, që pritet

të rinjve në këtë sistem të rëndësishëm dhe kjo mbështetje do të jepet në formë granti”, tha ai.

Hapja e programit IPARD III

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural I pyetur nga gazetaret gjithashtu se pritet hapja e programit IPARD III.

“Ne kemi përmbyshur detyrimet tona të kërkuara nga

përmes AZHBR-së, duke përfshirë për herë të parë edhe bashkitë.

Ai theksoi rëndësinë e skemës së kompensimit 10%, duke i bërë thirrje fermerëve të marrin autofaturë, pasi do të përfitojnë 10% të vlerës së faturave.

“Të gjithë ata që nuk janë formalizuar duhet të hapin një NIPT, në mënyrë që të bëhen pjesë e kësaj nisme. Nuk ka barrë financiare për biznesin që lëshon autofaturë për fermerin dhe procedura është e njëjtë, pa krijuar shqetësime për grumbulluesit apo agroturizmin”, sqaroi ministri.

Gjithashtu, do të vendoset një numër kontakti për fermerët për çdo problematikë apo orientim lidhur me Garancinë Sovrane dhe kompensimin e TVSH-së 10%.

Situata pas përmbytjeve

Ministri i Bujqësisë u ndal edhe te situata pas përmbytjeve.

“Kemi qenë në terren së bashku me Emergjencat Civile për të verifikuar situatën dhe për të qenë në kohë reale pranë fermerëve me mbështetje konkrete. Kemi ngritur një grup të përbashkët pune për të verifikuar të gjithë informacionin e marrë dhe shumë shpejt do të vijojmë me mbështetjen, sipas procedurave që kemi përcaktuar.

Po punojmë gjithashtu me Ministrinë e Financave për sigurimin e fermave, me qëllim që të hedhim një hap tjetër përpara dhe të shmangim problematika të ngjashme në të ardhmen. Paralelisht, po shqyrtojmë edhe çështjen e eksportit drejt tregut turk dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, po diskutojmë mënyrën e qasjes për ta adresuar këtë çështje në mënyrë më efektive”, u shpreh Salla.

“Monitor”

MBZHR: Paketë 5,2 miliardë lekë për fermerët, kompensim 10% dhe kredi me garanci

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla prezantoi Paketën e Mbështetjes për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2026, duke e

vestime në sektorët prioritarë të bujqësisë dhe blegtorisë.

Salla bëri të ditur se për herë të parë, ajo është hartuar pas 23 dëgjësive publike në të gjitha

produkteve bujqësore dhe blegtoriale, i cili përfshin faturat e lëshuara nga pika e grumbullimit, përpunuesit dhe subjektet e agroturizmit. Fermerët mund të dorëzojnë autofaturat çdo gjashtë muaj pranë zyrave tatimore rajonale dhe të përfitojnë rimbursimin direkt në llogaritë personale, duke siguruar një proces të thjeshtë dhe transparent”, shpjegoi ministri.

Për të mbështetur aksesin në financim, ministri po ashtu bëri të ditur se Qeveria ka vendosur një fond garancie prej 3 miliardë lekësh, i cili mbulon deri në 70% të kolateralit.

Kriteret përfshijnë normë interesi 2%, kredi deri në 25 milionë lekë për përfitues, afat shlyerjeje 3-5 vjet dhe periudhë grace jo më pak se 12 muaj.

Ministri Salla nënvizoi gjithashtu avancimin për hapjen e programit IPARD III brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, me një vlerë totale prej 147 milionë euro, duke garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe përputhje me standardet europiane.

Ministri Salla deklaroi se Paketa e vitit 2026 është një angazhim konkret për fermerët dhe zonat rurale dhe se Qeveria do të vazhdojë t’i dëgjojë fermerët dhe të investojë për një bujqësi më të fortë, më të formalizuar dhe më konkurruese, duke siguruar një të ardhme më të qëndrueshme për sektorin bujqësor dhe rural të Shqipërisë.



cilësuar si skemën më të madhe ndonjëherë për fermerët dhe agrobizneset shqiptare.

Ministri Salla nënvizoi se mbështetja e bujqësisë mbetet një prioritet strategjik i qeverisë shqiptare dhe theksoi se paketa e këtij viti, me një buxhet total prej 5,2 miliardë lekësh, ofron një qasje të integruar që synon rritjen e prodhimit, formalizimin e tregut dhe përmirësimin e potencialit tregtar të fermerëve.

“Kjo paketë sjell buxhetin më të lartë ndonjëherë për fermerët dhe agrobizneset, adreson nevojat prioritare të sektorit bujqësor dhe e përfaton atë me standardet e Bashkimit Europian”, tha ai.

Skema Kombëtare e Mbështetjes përfshin pagesa direkte për fermerët, si dhe in-

qarqet e vendit, ku fermerët paraqitën propozime konkrete, të cilat po shqyrtohen dhe do të reflektohen në draftin përfundimtar që më pas do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ministri shpjegoi edhe politikën për kompensimin 10% mbi vlerën e faturës së shitjes së produkteve bujqësore dhe blegtoriale.

Salla ftoi fermerët të marrin autofaturat dhe të jenë pjesë e kësaj pakete, në mënyrë që përveç përfitimit përmes skemës prej 5,2 miliardë lekësh të përfitojnë edhe 10% për çdo faturë në çdo produkt të bujqësisë. Për këtë, ministri theksoi rëndësinë e pajisjes së tyre me NIPT.

“Një nga nismat kryesore është kompensimi 10% mbi vlerën e faturës së shitjes së

Eksportet e fruta-perimeve arriten mbi 330 mijë tonë, shtatë laboratorë për sigurinë ushqimore

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla deklaroi gjatë një konference për shtyp se Shqipëria ka eksportuar vitin e kaluar mbi 330 mijë tonë perime dhe fruta drejt vendeve të Europës dhe më gjerë.

Ministri Salla bëri të ditur se qeveria do të vendosë një paketë mbështetjeje prej 70% për serrat që përdorin metoda të mbrojtjes biologjike, një mënyrë e rëndësishme për të garantuar sigurinë ushqimore dhe shëndetin e konsumatorëve.

Salla theksoi se mbrojtja biologjike është një nga metodat më të mira për të orientuar fermerët dhe për t’i bërë ata pjesë të paketës kombëtare për sigurinë ushqimore.

Ai shtoi se, për të lehtësuar tregun dhe për të shmanjur përdorimin e pesticideve, do të zbatohet Urdhri i ri i

Agronomit, i cili do të mbulojë të gjithë sektorin e bujqësisë.

Ky urdhër, sipas tij, do të kërkojë që çdo fermer apo biznes bujqësor të lidhet me një agronom për të garantuar gjurmueshmëri dhe cilësi të prodhimeve “nga bima deri në tavolinë”.

Përveç kësaj, ministri bëri të ditur se do të ndërtohen shtatë laboratorë në të gjithë territorin e Shqipërisë për të monitoruar sektorin e sigurisë ushqimore. Po ashtu do



të ndërtohen edhe pesë laboratorë në pikat kufitare për të garantuar kontroll më të madh mbi eksportet dhe importet.

Laboratorët do të mbulojnë zonat kryesore bujqësore, duke përfshirë qarqet Fier, Korçë, Vlorë dhe Kukës.

Ministri Salla gjithashtu foli për rëndësinë e reformimit të stafit të institucioneve si AKU, për të përmirësuar monitorimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore.

Një tjetër sektor që do të marrë mbështetje të veçantë, sipas tij, është bletaria.

Ministri informoi se qeveria synon të dyfishojë mbështetjen për bletë, duke synuar rritjen e numrit të kolonive (koshere) nga mbi 600 mijë aktualisht në 1 milion, si dhe duke mbështetur çdo kilogram mjaltë me 10% të vlerës së tij në kuadër të paketës.



të hapet brenda 6 muajve.

Ministri i Bujqësisë bëri të ditur se Skema Kombëtare për Bujqësinë me fonde me vlerë 5.2 mld lekë do të sjellë masa të reja mbështetëse për blegtorët e rinj.

“Ne kemi diskutuar të gjitha masat e reja që do të vendosim për aplikim në skemën e re kombëtare. Jemi duke rishikuar masat e zbatuara në vitin 2025, për të gjetur metodologjinë më të përshtatshme. Brenda pak ditësh do të dalim me skemën e re, ku do të përfshihet edhe skema për naftën.

Një nga risitë kryesore do të jetë mbështetja për blegtorët e rinj. Sipas Sallës, po diskutohet mundësia që të rinjtë dhe të rejtat nga mosha 18 deri në 35 vjeç të përfitojnë grant nga 7 mijë deri në 10 mijë euro për hapjen e një biznesi, kryesisht në blegtori.

Synojmë që çdo i ri apo e re që hap një biznes në këtë sektor të jetë pjesë e mbështetjes sonë financiare. Duam të trisim rolin e

Bashkimi Europian. Çështjet që lidhen me drejtësinë i takojnë institucioneve përkatëse. Më 9 mars do të jemi në Bruksel me synimin që brenda 6 muajve të hapet programi IPARD III. Fondi me vlerë 112 milionë eurosh pritet që të jenë në dispozicion brenda këtij viti në bashkëpunim me Bashkimin Europian. Kjo është një mundësi shumë e mirë që sektori bujqësor të vazhdojë me mbështetjen e masave të reja që do të vendosim me qeverinë shqiptare prej 5.2 mld lekë të ndërthura me masat e programit të IPARD III”, deklaroi ministri.

Garancia Sovrane dhe kompensimi 10%

Salla foli edhe për Garancinë Sovrane, e cila synon të lehtësojë aksesin në financim dhe të orientojë fermerët për të qenë pjesë e paketës mbështetëse

Rishikohet mënyra e përfitimit nga skema e naftës, bashkitë pjesë e procesit të aplikimit për fermerët

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla bëri të ditur se pritet të rishikohet mënyra e përfitimit nga skema e naftës, si pjesë e paketës së re mbështetëse.

“Jemi duke diskutuar masat e reja që do të aplikohen brenda pak ditësh në skemën kombëtare. Po rishikojmë procesin e aplikimit dhe paketat e mbështetjes për fermerët, përfshirë edhe mbështetjen për naftën. Shumë shpejt do të dalim me skemën e re që do të përfshijë të gjitha këto masa”, tha Salla.

Ai shtoi se prioritet do të kenë

blegtorët dhe të rinjtë që duan të investojnë në këtë sektor.

“Do të mbështesim blegtorët për të rritur numrin e tyre dhe për të ofruar mbështetje financiare të kërkuar gjatë takimeve në 12 qarqet e vendit. Ky sektor do të jetë prioritar për masat e reja”, tha



ministri.

Salla bëri të ditur se Garancia Sovrane dhe bashkëpunimi me bankat e nivelit të dytë do të lehtësojnë aplikimin për fermerët.

“Kemi pasur takim me guvernatorin dhe bankat e nivelit të dytë për të lehtësuar dhe orientuar fermerët për të aplikuar për garancinë sovranë. Në mbështetje do të jenë edhe AZHBR dhe agropikat që kemi në terren. Për herë të parë dhe bashkitë do të mbështesin procesin, duke na orientuar e duke bërë një kontroll në të gjithë aplikimet që ne do të kryejmë”, tha Salla.

300 hektarë nën ujë prej dy muajsh, fermerët në Lushnjë paralajmërojnë dëme të mëdha

Për të pestën herë në disa zona bujqësore, në Lushnjë dalja e lumit nga shtrati ka shkaktuar përmbytje të mëdha

Vetëm në zonën e Zhelizhanit në Lushnjë mbi 300 ha fruta dhe ullishte kanë dy muaj që qëndrojnë në ujë. Sipas fermerëve dëmin ja u bën shkarkimi i hidrocentralit të Banjës.

I gjithë investimi i 15 viteve të fundit në këtë zonë për fermerët është në kultivimin e frutave. Të rinjtë u kthyen nga emigrimi për t'iu përkushtuar pemtarisë, por në këtë situatë ata ndihen të dëshpëruar. Nëse uji nuk tërhiqet shpejt, rrezikojnë t'i humbasin plotësisht pemët.

Ndërkohë, fermerët par-

alajmërojnë se nëse situata përsëritet edhe në ditët në vijim, dëmet ekonomike do të jenë të konsiderueshme, duke rënduar më tej gjendjen financiare të familjeve që jetojnë me bujqësi.



Bujqësia dhe dashuria për tokën - Besnik dhe Durime Murataj nga Piskova të përkushtuar në vreshtari

Mes rreshtave të vreshtave në Piskovë, puna nis herët dhe mblyllet vetëm kur dita përëndon.

me krasitjen e vreshtave, një proces i domosdoshëm për mbarëvajtjen dhe prodhimtari-

tet e saj dhe jemi pak pas me punët. Pas krasitjes vreshti do një spërkatje dimërore. Problemi më i madh i joni është shitja. Ne marrim rreth 6-7 milion lekë të vit, hiq këtu 3 milion shpenzime.” U shpreh për RTSH fermeri Besnik Murataj.

Durime Murataj, e cila punon krah për krah me bashkëshortin, tregon se me kalimin e viteve ka mësuar të gjitha proceset e punës në vreshta, nga krasitja deri te mirëmbajtja dhe vjelja.

Për Besnikun dhe Durimen, bujqësia nuk është thjesht një burim jetese, por një mënyrë jetese që kërkon sakrificë, përkushtim dhe dashuri për tokën.



Besnik dhe Durime Murataj janë një çift që i janë përkushtuar prej vitesh punës në bujqësi.

Aktualisht ata po merren

në e rrushtit në sezonin e ri.

“Puna ka rreth një muaj që ka filluar me krasitjen dhe tani jemi në periudhën e lidhjes. Lagështia ka bërë efek-

Moti i paqëndrueshëm pengon punët në bujqësi – Lagështia e tokës ndalon nisjen e plugimit në Gjirokastrë

Kushtet e pafavorshme klimatike kanë krijuar vështirë-

zonin e ri.

“Nëse do flasim për pl-



si për fermerët në zonën e Gjirokastrës. Reshjet e vazhdueshme të shiut gjatë kësaj periudhe kanë penguar zhvillimin normal të punimeve bujqësore, duke sjellë vonesa në përgatitjen e tokave për se-

ugimet pranverore nuk janë kryer pothuajse fare këto plugime sic mund të ishte përgatitja për mbjelljen e jonxhës por edhe për mbjelljen e kulturave të tjera”, u shpreh Specialist i bujqësisë, Balil

Bineri.

Fermerët e zonës së Lunxhërisë shprehen të shqetësuar për vonesat, por theksojnë se po e shfrytëzojnë këtë kohë për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve bujqësore.

Në muajin shkurt zakonisht tokat që mbillen në pranverë duhet të kishin përfunduar të gjitha”, tha fermeri Vangjel Kondi.

Fermerët mbeten në pritje të përmirësimit të kushteve atmosferike, me shpresën që vonesat të mos ndikojnë ndjeshëm në ecurinë e sezonit bujqësor. Megjithatë, situata mbetet e varur nga zhvillimet e ditëve në vijim, ndërsa çdo ndryshim i motit do të jetë vendimtar për ritmin e punimeve në terren.

Furrat e bukës pa furrxhinj, Shoqata e Prodhuesve letër Ibrahimajt: Subvenciononi fuqinë punëtore

Shoqata e Prodhuesve furrat e bukës nuk ka bukëbërës të Bukës, Pasticërisë dhe (Furrxhi)”, theksohet në letër.



Brumërave në një konferencë për shtyp ka ngritur shqetësimin e mungesës së punëtorëve.

Prodhuesit e Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave lajmëruan se për mungesën e punonjësve veçanërisht për profesionet furrxhi dhe pasticier, i janë drejtuar edhe me një letër ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit Delina Ibrahimaj.

“Prej kohësh Kryesia e Shoqatës dhe Administratorët e furrave të bukës janë të shqetësuar nga mungesa e fuqisë punëtore veçanërisht të specialistëve të bukës që tashmë është kthyer në një situatë alarmante. Pra për

Sipas tyre mungesa e fuqisë punëtore është ndikuar nga rënia e nxënësve në shkollat profesionale, veçanërisht për degën teknologji ushqimore. Problem sipas Shoqatës është edhe mungesa e interesimit të të rinjve për të punuar dhe mësuar zanatin e bukëbërësit.

Për këtë vit shkollor sipas Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave numri i nxënësve rezulton me rënie rreth 70% krahasuar me numrin e nxënësve për vitin 2018-2019 që ndiqnin arsimin profesional për degën e “Teknologjisë ushqimore”. Ndërsa për grupin Bukë

– Pasticëri pothuaj nuk ka fare nxënës.

“Kjo mungesë është një goditje e rëndë për mënyrën artizanale të prodhimit të bukës tek ne, që bazohet tek puna e dorës së specialistëve”, theksohet ndër të tjera në letër.

Nisur nga situata e krijuar me mungesën e fuqisë punëtore, Shoqata e Prodhuesve të Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave kërkon ndërhyrjen e qeverisë me marrjen e disa masave, si:

• Kërkojmë trajtimin e “Bukëbërësit” – si Zanat në zhdukje. Kjo nuk është thjeshtë mbrojtja e një kategorie punonjësish por mbart në vetvete një Aset Kombëtar.

• Ne kërkojmë masa konkrete për të tërhequr kontigjente të rinjsh të interesuar për këtë zanat, duke siguruar bursa studimi, mundësi akomodimi si dhe lehtësi të tjera.

• Kërkojmë të subvencionohet kategoria e specialistit “Bukëbërës” (Furrxhi), me pagesa specifike për të lehtësuar pagat e larta që kërkohet në kushtet e mungesës të fuqisë punëtore”
“Monitor”

Riciklimi i mbetjeve - Tetë tonë karton dhe plastikë u përpunuan brenda pak javësh në Përmet

Në hyrje të qytetit të Përmet, aty ku prej vitesh mbetjet grumbulloheshin pa shumë vëmendje, sot funksionon një pikë që po kthen plastikën dhe kartonin në burim vlere për komunitetin.

Vetëm brenda pak javësh, tetë ton karton dhe plastikë janë përpunuar, duke dhënë sinjalin e parë konkret se riciklimi në qytet ka nisur të japë rezultate të frytshme.

“Kemi filluar që 20 janar dhe kemi arritur deri në 8 tonë dhe këto të ndara, 6 tonë karton dhe 2 ton plastik. Në qytet kemi shpërndarë kosha plastik”, u shpreh Eftali Lapaj, Përgjegjës e sektorit të Pastrim-Gjelbërimit.

Ndërkohë, punonjësit janë përshtatur me mënyrën e re të punës për riciklimin e mbetjeve,

duke rritur efikasitetin në ndarjen dhe përpunimin e tyre.

“Për sa kemi filluar në këto muaj jemi përshtatur me punën

Nga instancat përgjegjëse apelohehet për më shumë bashkëpunim me komunitetin, me qëllim që mbetjet të hid-



por ka dhe procese të vështira dhe përkushtimi duhet të jetë më i madh”, tha punëtori Faik Demçallari.

hen në vendet e përcaktuara dhe të lehtësohet procesi i grumbullimit të mbetjeve për riciklim.

Buzaishta, fshati që nuk u braktis - Uji dhe kultivimi i patates kanë frenuar braktisjen në zonën e Mokrës

Ndryshe nga shumë fshatra të zonës së Mokrës që po përballeshin me braktisjen, Buzaishta në njësinë administrative Velçan vijon të mbetet një fshat i gjallë dhe me popullsi të qëndrueshme.

Me rreth 560 banorë dhe afro 100 familje, ky komunitet ka arritur të ruajë jetën rurale falë burimeve të bollshme ujore, tokës pjellore dhe angazhimit

të vazhdueshëm në bujqësi.

“E vetmja arsye ka qenë patatja e cila këtu është konsumuar masivisht”, u shpreh Dëfrim Çela.

“Fshati ynë ka qenë gjithmonë nga ata që e duan tokën, dhe një arsye tjetër është se ne kemi dhe ujin për të vaditur. Toka gjithmonë punohet këtu”, u shpreh Kryeplaku Hymer Çela.

Buzaishta ka një shkollë funksionale me rreth 50 nxënës, ambulancë dhe shërbime bazike, ndërsa sfida kryesore mbetet infrastruktura rrugore dhe rrjeti i amortizuar elektrik. Në një kohë kur shumë zona rurale po zbrazen, Buzaishta mbetet një shembull se uji, toka dhe puna mund të mbajnë gjallë një komunitet të tërë.

Përmbytjet përgjysmuan eksportet e zarzavateve në janar

Eksportet shqiptare të zarzavateve kanë nisur vitin 2026 me një rënie të fortë, duke reflektuar ndikimin e përmbytjeve që prekën zonat kryesore bujqësore dhe serat e specializuara për tregjet e jashtme në fillim të vitit.

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT për muajin janar, vendi eksportoi 5,367 ton zarzavate, nga 9,936 ton në janar 2025, me një tkurrje prej rreth 46% në baza vjetore.

Rënia është edhe më domethënëse nëse merret parasysh se janari i vitit të kaluar shënoi kulmin e dekadës për këtë muaj. Viti 2025 u karakterizua nga zgjerimi i prodhimit në sera dhe kërkesa e lartë nga tregjet europiane, duke e çuar eksportin në nivele rekord. Vjet pati një interes të lartë nga Europa për prodhime të stinës si lakra dhe karota, çka nxiti mbjellje të reja në fushë. Teksa ky trend vijoi edhe këtë sezon, përmbytjet e janarit dëmtojnë qindra hektarë të mbjella në fushë.

Megjithatë, edhe pas kësaj goditjeje, niveli i eksporteve mbetet më i lartë krahasuar me shumicën e viteve para pandemisë, kur eksportet e janarit luhateshin zakonisht midis 1.8 dhe

3.8 mijë tonëve. Rritja e viteve të fundit kishte krijuar një bazë më të fortë prodhimi, por fillimi i vitit 2026 tregon se sektori mbetet shumë i ekspozuar ndaj rreziqeve klimatike.

Megjithatë, përmbytjet e fillimit duket se kanë goditur drejtpërdrejt prodhimin dhe logjistikën e eksportit. Zonat kryesore të prodhimit në ultësirën perëndimore u përballën me dëmtime të kulturave, ndërsa vështirësitë në transport dhe furnizim kanë kufizuar dërgesat drejt tregjeve europiane.

Pas disa vitesh rritjeje të



qëndrueshme dhe investimesh në sera, përmbytjet treguan se infrastruktura mbrojtëse dhe menaxhimi i riskut klimatik po bëhen faktorë kritikë për stabi-

litetin e eksporteve.

Operatorët presin rikuperim gradual të eksporteve në vijim, por fillimi i vitit ka rritur pasigurinë për eksportuesit e zarzavateve. Rritja e eksporteve bujqësore si në sasi dhe në vlerë dhe në anën tjetër rënia e prodhimit po tregon se sektori po shkon drejt konsolidimit.

Bujqësia shqiptare ka hyrë në një fazë konsolidimi me rënie në total, por me një orientim më të fortë nga eksporti. Fermat e vogla dhe mesme në zonat e rurale të vendit po falimentojnë nga tkurrja dhe plakja e popullsisë, teksa po

rriten dhe po zgjerohen fermat e mëdha blegtorale dhe ato në sera në zonat me bujqësi intensive si Fieri, Lushnja etj. me destinacion eksportin.

Projekti për klimën dhe bujqësinë sërish “notë” negative, BB: Ka vonesa të theksuara në afate

Zbatimi i një projekti kyç për rezistencën klimatike dhe zhvillimin bujqësor në Shqipëri po ecën më ngadalë se planifikimi fillestar, me pro-

larg objektivave kryesore. “Pas një fillimi premtues, implementimi ka përjetuar vonesa të konsiderueshme, me një prapambetje të vlerësuar rreth 18



gres të kufizuar financiar dhe operacional.

Bëhet fjalë për projektin “Për Rezistencë Klimatike dhe Zhvillim Bujqësor” i financuar nga Banka Botërore me një kredi 70 milionë USD dhe i përbërë nga tre komponentë.

Në vlerësimin e fundit të Bankës për këtë projekt, ecuria ka mbetur sërish “i pakënaqshëm në mënyrë të moderuar”. Sipas raportit të zbatimit, projekti ka hyrë në një fazë ku rezultatet mbeten

muaj dhe nivel të ulët disbur-simi, aktualisht në 8 për qind”

Progresi drejt objektivave të zhvillimit i reflektuar në “i pakënaqshëm në mënyrë të moderuar” reflekton se komponentët kryesorë të investimeve nuk kanë avancuar sipas planit. Aktivitetet infrastrukturore dhe ndërhyrjet për rritjen e qëndrueshmërisë bujqësore nuk kanë hyrë ende në fazë zbatimi të plotë. Raporti thekson se ritmi i ngadalë kërkon ndërhyrje institucionale më të fortë.

“Ruajtja dhe ndërtimi mbi progresin përgatitor të mëparshëm kërkon angazhim të fortë drejtues, vendimmarrje në kohë dhe koordinim më të mirë mes institucioneve zbatuese.”

Banka nënvizon se autoritetet përgjegjëse, përfshirë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kanë përgatitur një plan veprimi për të përshpejtuar zbatimin dhe për të rikthyer projektin në trajektoren e synuar.

“Zbatimi strikt i planit të veprimit dhe mbikëqyrja në nivel të lartë do të jenë vendimtare për përmirësimin e performancës dhe arritjen e objektivave brenda periudhës së mbetur të projektit” thuhet në dokumentin e BB.

Projekti në fjalë u miratua në mars 2023. Objektivi i tij është rritja e konkurrueshmërisë dhe rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike të zinxhirëve prioritarë agroushqimorë, duke përmirësuar sistemet bujqësore, aksesin në tregje dhe aftësinë për përbalimin e goditjeve të klimës.

“Monitor”

Dhoma Amerikane e Tregtisë: Nevojë për forcimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së e-Albania

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) në një deklaratë publike ka ngritur shqetësime lidhur me funksionimin e platformës “e-Albania” dhe sistemeve, duke paralajmëruar rreziqe për bizneset, sigurinë e të dhënave dhe stabilitetin ekonomik.

AmCham, shprehet se “vlerëson përpjekjet dhe investimet publike të Qeverisë së Shqipërisë në digjitalizimin e shërbimeve publike, përfshirë zhvillimin e platformës e-Albania, si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Megjithatë, duke qenë se sistemet digjitale qeveritare administrojnë të dhëna shumë sensitive, mungesa e auditimit, sigurisë dhe përditësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare përbën rreziqe serioze për stabilitetin ekonomik, vazhdimësinë e bizneseve dhe sigurinë kombëtare”.

AmCham thekson se “shpreh shqetësim të veçantë në lidhje me reagimet e vazhdueshme të marra nga anëtarët e saj pas zhvillimeve të fundit që lidhen me AKSHI-n. Sipas raportimeve të anëtarëve, disa shërbime të platformës e-Albania aktualisht funksionojnë në mënyrë të paqëndrueshme dhe nuk përmbushin nevojat operacionale të bizneseve dhe qytetarëve.

“Këto shqetësime përfshijnë ndërprerje të shërbimeve, vonesa, akses të kufizuar gjatë orareve të ngarkuara dhe performancë të paparshtueshme të sistemit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ndërprerjen e aktivitetit normal të bizneseve. Ndër-

preje të tilla kanë një ndikim të prekshëm dhe të menjëhershëm negativ në aftësinë e kompanive për të përmbushur detyrimet rregullatore, për t’u shërbyer klientëve dhe për të zhvilluar operacionet e përditshme”, thuhet në deklaratë.

Sipas AmCham, ky

anëtarët e AmCham raportojnë shqetësime të vazhdueshme lidhur edhe me proceset e prokurimit publik në sektorin TIK. Këto shqetësime cenojnë konkurrencën e ndershme dhe përdorimin efektiv të fondeve publike, duke rritur njëkohësisht rreziqet që lidhen me

garantimin e transparencës, eficiencës dhe mbrojtjes së fondeve të taksapaguesve”, cilëson AmCham.

Për këtë arsye, AmCham i bën thirrje Qeverisë të ndër-marrë masa korrigjuese të menjëhershme për të garantuar funksionimin e pandër-

disponueshme për palët e interesuara.

AmCham, propozon autorizim sigurie, verifikim dhe kontroll aksesi për forcimin e efektivitetit dhe nivelit të maturimit të mekanizmave ekzistues për autorizim sigurie, verifikim dhe kontroll aksesi në sistemet TIK qeveritare, në përputhje me rregulloret në fuqi për sigurinë e informacionit, menaxhimin e databazave shtetërore, prokurimin e informacionit të klasifikuar dhe ligjin e prokurimit publik. Duke njohur praktikën e zbatuar prej AKSHI-t, rekomandohet vlerësimi dhe përmirësimi i këtyre mekanizmave, përfshirë kontrollin e aksesit të bazuar në role, në linjë me Direktivën NIS2 të BE-së dhe praktikën më të mira të shteteve anëtare.

“Përcaktimi dhe zbatimi i kërkesave minimale për nivelin e shërbimit (SLA) lidhur me funksionimin, kohën e rikuperimit dhe performancën e sistemeve kritike, duke përfshirë redundancën, rikuperimin nga fatkeqësitë dhe vazhdimësinë e biznesit, në përputhje me ISO/IEC 22301 dhe parimet e reziliencës digjitale të BE-së”, thuhet në deklaratë.

AmCham sugjeron rritjen e efektivitetit dhe maturimit të procedurave ekzistuese të prokurimit në sektorin TIK, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për sigurinë e informacionit, menaxhimin e databazave shtetërore, prokurimin e informacionit



shqetësim është veçanërisht i rëndësishëm, pasi Dhoma përfaqëson një numër të konsiderueshëm kompanish anëtare që operojnë në ekosistemin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe sektorë të lidhur me të.

Në deklaratë thuhet se shumë prej këtyre kompanive janë të certifikuar ndërkombëtarisht, zbatojnë standarde të larta sigurie dhe rregullatore, dhe disa prej tyre janë të verifikuara plotësisht dhe të autorizuar për të ofruar shërbime për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

“Megjithatë, pavarësisht kësaj eksperience të fortë vendase dhe ndërkombëtare,

menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave tepër sensitive”, vijon deklarata.

“Këto të dhëna përfshijnë informacion që lidhet me institucionet publike, bizneset, të dhënat personale dhe pasurore të qytetarëve, si dhe informacione të tjera me rëndësi kritike për funksionimin e shtetit dhe ekonomisë. Në krahasim, në Shtetet e Bashkuara dhe në ekonomitë e tjera të avancuara, kompanitë e përfshira në sistemet TIK qeveritare dhe sistemet sensitive i nënshtrohen proceseve strikte të verifikimit, kërkesave për autorizim sigurie dhe kontrolleve financiare, përfshirë edhe kufizime mbi marzhet e fitimit, me qëllim

prerë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të gjitha shërbimeve të e-Albania-s, me fokus të veçantë të shërbimet kritike për aktivitetin e biznesit dhe prokurimet.

Në zgjidhjet afat shkurtra, AmCham propozon ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme si krijimin e një kuadri ligjor të detyrueshëm për auditime periodike dhe të pavarura të IT-së dhe sigurisë kibernetike për të gjitha platformat kritike të e-Government, të kryera në përputhje me standarde ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të BE-së, përfshirë ISO/IEC 27001, ISO/IEC 22301, NIST, SOC 2 dhe udhëzimet e ENISA, me përmbledhje ekzekutive të

të klasifikuar dhe ligjin e prokurimit publik. Duke njohur praktikën aktuale të AKSHI-t, rekomandohet forcimi i vlerësimit mbi bazë merite, përmes peshimit më të qartë të kriterëve teknike, certifikimeve, përvojës dhe profilit të sigurisë, në linjë me Direktivat e BE-së për Prokurimin Publik.

Sipas deklaratës, duhet të ketë një komunikim të strukturuar dhe njoftim të detyrueshëm për incidentet si krijimi i mekanizmave zyrtarë për njoftimin e bizneseve dhe qytetarëve mbi mirëmbajtjet e planifikuara, incidentet dhe ndërprerjet e shërbimit, përfshirë kohën e parashikuar të zgjidhjes dhe raportet pas incidentit, në përputhje me detyrimet e raportimit sipas NIS2.

Sipas AmCham, duhet të ketë një kuadër të rregulluar për integrimin e sistemeve që u mundëson sektorit privat të integrohen me platformat e e-Government, aty ku është e përshtatshme, në përputhje strikte me GDPR, eIDAS/eIDAS2, standardet e sigurisë kibernetike dhe rregullat e përcaktuara të kontrollit të aksesit, për të mbështetur automatizimin dhe reduktuar barrën administrative.

AmCham shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me Qeverinë duke ofruar ekspertizë teknike dhe duke ndarë praktikën më të mira ndërkombëtare, veçanërisht ato të zbatuara në Shtetet e Bashkuara, me qëllim forcimin e qeverisjes, minimizimin e rreziqeve të korrupsionit, mbrojtjen e të dhënave sensitive dhe rritjen e sigurisë kombëtare dhe ekonomike.



BASHKIMI KOMBËTAR I FERMERËVE SHQIPTARË

Adresa: Rr. "Mine Peza", Pall. 87/3, Hyrja 1, Kati 1, Tiranë, Albania
Tel/Fax: ++355 4 259195, E-mail: bkfsh@abmc.org.al

Të mbrohemi në maksimum nga rreziku i përmbytjeve në bujqësi

Bashkimi Kombëtar i Fermerëve të Shqipërisë (BKFSH) shpreh shqetësim mjaft të mëdha për dëmin e madh që solli përmbytja e fillimit të Janarit të këtij viti për bujqësinë në tërësi dhe fermerët e Shqipërisë në veçanti. Kjo përmbytje ishte një fatkeqësi e madhe e shoqëruar me shumë dëme në disa bashki.

Dëme më të mëdha nga përmbytja kishin bashkitë e Shkodrës, bashkia e Lezhës, që shkojnë me mijëra hektarë të përmbytur si rezultat i zmadhimit të liqeneve dhe të lumenjve. Dëme pati në Dibër si rezultat i prurjeve të mëdha të lumit Drini i Zi, ku përmbyti gjithë luginën e Drinit, me një sipërfaqe mbi 1500 hektarë tokë bujqësore. Shumë përmbytje dhe dëme pati Bashkia e Durrësit, veçanërisht në Kënetë, në Spitalë dhe 4 njësitë administrative ku vetëm në nj.adm. Sukthi i Ri pati mbi 84 hektarë tokë të përmbytur me 140 krerë bagëti të imëta, 270 shpendë dhe 280 kuintal koncentrat për blegtorinë, dhe 1570 dengje jonxhë e bar të thatë. Në njësinë administrative Katund i Ri, ka familje si familja Balla 3 vëllezër, të cilëve iu përmbytën 195 hektarë tokë, nga kjo 42 hektarë të mbjella me grurë. Në Durrës u përmbytën mbi 800 shtëpi në shkallë Bashkie.

Në bashkinë e Fierit u përmbytën 1329 hektarë tokë dhe 21 hektarë serra të mbjella. U dëmtuan 6 gjedhe, 36 krere bagëti të imëta dhe 1200 shpendë. Në bashkinë e Lushnjes u përmbytën mbi 1200 hektarë tokë dhe 31 hektarë serra të mbjella. Në Vlorë u

përmbytën 100 hektarë tokë, kryesisht në Novoselë. Dëme të mëdha pati shumë në bashkinë e Dimalit të Beratit, ku u përmbytën 650 hektarë tokë bujqësore, ku brenda saj ishin 110 hektarë serra të mbjella. U dëmtuan 52 krerë bagëti të imëta si dhe 630 kuintal koncentrat dhe 15816 dengje jonxhë e bar të thatë për blegtorinë.

Për fat vetëm në Bashkinë e Tiranës, të Vorës, Malësisë së Madhe, Kavajës, Pogradecit dhe disa bashki të tjera nuk pati dëme dhe përmbytje. Këto ishin disa nga bashkitë e verifikuara.

Parandalimi i rrezikut nga përmbytja

Ku rreziqet mund të priten se vijnë, ilaçi i rregullimit është parandalimi dhe marrja e disa masave paraprake ndër të cilat:

a) Kullimi i plotë në të gjithë tokat me cilësi të lartë, që çdo kanal t'i jepet e sigurtë derdhja sipas kategorisë, deri në kanalet ujëmbledhëse që do të derdhen në lumenj, në liqene apo në det. Zona që kërkon kullim çdo vit përfshin më shumë zonat fushore prej 280 mijë hektarë toke. Kjo kërkon që të lëvizin mbi 8 milion metër kub dhera. Ky volum realizohet nëse mobilizohen 61 ekskavatorë krahëgjatë të bashkive dhe ekskavatorët e bordeve të kullimit, dhe ekskavatorët e vegjël të bashkive. Realisht kjo nuk është realizuar sa duhet pasi ekskavatorët krahëgjatë të bashkive janë përdorur shumë pak në këtë aksion. Zakonisht ekskavatorët krahëgjatë duhet të përdoren më shumë

në ndërtimin e bankinave dhe pritave të lumenjve në kanalet e para dhe ujëmbledhësit dhe kanalet e ujërave të larta. Këto lloj kanalesh janë shumë problem dhe mospastrimi bllokon gjithë kanalet e tjera. Është shumë serioze se kanalet ujëmbledhës gjen në disa bashki pa pastruar me dhjetëra vite. Këto kanalet bllokohen nga kallamishet, barnat dhe mbeturinat duke bllokuar të gjithë ujërat që mblidhen nga kanalet e tjera. Presim që kësaj gjendjeje t'i dilet përpara nga bashkitë dhe bordet e kullimit nga Ministria e Bujqësisë.

Punë të mirë ka bërë bashkia e Durrësit që pastroi mbas disa vitesh kanalën e madh të Tonës 6.5 km të gjatë me gjerësi mbi 6-7 meter dhe thellësi mbi 3 metër. Ky kanal mbledh ujërat e zonës nga Sukthi deri në Hamallaj.

Kanalet e dyta dhe të treta si për kullim ashtu dhe kanalet ujitëse, janë detyrë e bashkive t'i pastrojnë. Shqetësim këtu është se numri i ekskavatorëve të vegjël edhe fadromave është i ulët për bashkitë. Ka bashki si Shijaku etj që kanë vetëm 1 deri 2 ekskavatorë të vegjël. Bashkitë e Durrësit dhe disa të tjera kanë 2-3 ekskavatorë, përjashtuar Tiranën edhe Lezhën që kanë 4-6 ekskavatorë dhe fadroma. Në këtë gjendje nuk përballohet pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse. Kërkohej patjetër investim për t'i pajisur me më shumë ekskavatorë bashkitë.

b) Ndërtimi i bankinave në 8 lumenjtë e fuqishëm.

Ky është problemi më i rëndësishëm, zgjidhja e të cilit mbron shumë lumenj agresivë

nga përmbytjet si Drini i Zi, Erzeni, Shkumbini, Semani, Vjosa etj të cilët kanë shumë nevojë për bankina e prita të betonuara. Nevojë kanë edhe disa lumenj të vegjël malorë që mbeten agresivë. Një punë e mirë është bërë nga Bashkia e Durrësit këto 2 vitet e fundit në ndërtimin e bankinës në lumenj Erzen në njësinë administrative Sukthi i Ri, prej 6 km bankinë, e cila shpëtoi qindra familje dhe shumë hektarë tokë pa u përmbytur në Janar të këtij viti. Kështu duhet vepruar edhe në bashki të tjera me investime nga qeveria dhe me projekte të sakta nga inxhinierë dhe pa vonuar pasi çdo vonesë sjell pasojë të rrezikshme.

c) I domosdoshëm është investimi për infrastrukturë kullim-ujitje.

Në fakt, investimi nga viti 2017 ka qenë i vogël. Strategjia e viteve 2017-2027 ka patur ne plan që të investoheshin 74.7 milion dollarë çdo vit. Në fakt nga 2017-2023 duheshin investuar 520 milion dollarë, ku nga të cilat janë investuar vetëm 147 milion dollarë, me mos-realizim 375 milion dollarë. Edhe strategjia e vitit 2019-2031 është realizuar vetëm 40%. Edhe në buxhetin e vitit 2022 u ulën investimet për infrastrukturë kullim-ujitje me -55% të planifikimit. Goditja e dhënë ka qenë edhe mos-financimi nga Banka Botërore dhe bllokimi i IPARD-3 nga vitit 2023 prej 146 milion euro në vit. Kjo situatë e rëndon shumë bujqësinë pasi rrezikohet që të kënetëzohet Shqipëria vetëm për mos-investime.

d) Rrezik shumë i madh për

përmbytjen është edhe hapja pa kriter i liqeneve dhe rezervuarëve.

Shqipëria është një ndër vendet me rezerva ujore më shumë ku disponon 5 liqene me përmasa të mëdha me 1200 km², 247 liqene artificiale, disponon 670 rezervuarë për ujitje, 200 burime nëntokësore me 200 litra ujë në sekondë çdo burim. Disponon 8 lumenj të mëdhenj dhe 152 lumenj të vegjël që derdhen në detin Adriatik. Kjo sasi është e mirë po të shfrytëzohet për ujitje por është e keqe dhe e rrezikshme për përmbytjet.

Eksperiencia ka treguar se përmbytjet nuk vijnë vetëm nga rënia e shirave, pa hapur digat e liqeneve ose të rezervuarëve. Kështu hapja e portave të liqenit të Komanit pa kriter mbytet Shkodra dhe Lezha. Hapja e portave të Liqenit në Shehur, në juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, egërsohet dhe bën përmbytje Drini i Zi. Hapja e portave të liqenit të Farkës në Tiranë, shton në mënyrë masive lumin Erzen. Po kështu dhe hapja e liqenit të Ulzës dhe Shkopetit, përmbyt zonat e mëdha. I njëjti kujdes duhet dhe për lumenjtë e vegjël dhe rezervuarët. Dihet se forcën e natyrës nuk mund ta ndalojmë se nuk e kemi në dorë. Por masat parambrojtëse i kemi në dorë nëse duam që seriozisht ta mbrojmë mirë Shqipërinë nga përmbytjet dhe dëmtimet siç ndodhi këtë rradhë si asnjë vit tjetër.

Bashkimi Kombëtar i Fermerëve i kërkoi Qeverisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Bashkive ta marrin seriozisht

këtë situatë në dorë. Të investojnë sa më parë për këto probleme, dhe ta mbrojmë Shqipërinë nga rreziku i këtij armiku pa armë në dorë.

Kërkojmë të mbarojë sa më shpejt vlerësimi i dëmeve në Bujqësi dhe Blegtori për bletët, bazën ushqimore, koncentratin, dhe të vlerësohen në përgjithësi dhe të paguhen nga shteti, siç ka porositur dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, për t'u shpërblyer çdo dëm i krijuar. Kërkojmë vlerësim nga Bashkitë përkatëse, duke caktuar specialistë më të aftë për verifikimin e dëmeve dhe kërkojmë nga Ministria e Financave dhe e Bujqësisë të zhdëmtohet çdo dëm i shkaktuar nga këto përmbytje.

Eksperiencia e hidhur e disa viteve më përpara, ka treguar se shumë dëmtime nuk janë vlerësuar dhe nuk janë paguar, siç është rasti i dëmtimit të qershivë, kumbullave dhe mollëve, në kohën e lulëzimit në vitin që kaloi 2025.

Kërkojmë aktivizimin dhe kontrollin më të saktë dhe me përgjegjësi të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, pasi fermerët dhe biznesmenët në Bujqësi kanë disa vërejtje për punën e këtyre drejtorive rajonale të bujqësisë.

Duke patur besim, tek Qeveria, Ministria e Bujqësisë dhe Bashkitë, shpresojmë se kësaj situatë do t'i dilet përpara për të mos u përsëritur asnjë vit tjetër, si ky vit.

**Me respekt dhe besim,
Hakis Sava
Kryetar në detyrë
i B.K.F.SH.**

Pasioni për bletarinë - Anastas dhe Aleksandra Çano 85 e 75 vjeç sot kujdesen për 11 koshere

Në fshatin Stegopol, pjesë e Libohovës, Anastas Çano, 85 vjeç, dhe Aleksandra Çano, 75 vjeç, kanë zgjedhur që edhe në një moshë të thyer të vazhdojnë traditën e hershme familjare të bletarisë. Prej vitesh ata janë kujdesur për kosheret me bletë, duke e kthyer këtë zanat në pjesë të pandarë të jetës së tyre. Dikur përkujdeseshin për një numër më të madh kosheresh, ndërsa sot, për shkak të moshës, mbajnë rreth 11 të tilla. Megjithatë, përkushtimi dhe dashuria për bletarinë mbeten të njëjta.

Ata tregojnë se bletaria është një zanat i bukur dhe i

dobishëm, që kërkon durim dhe përkujdesje të vazhdueshme.

"Është shumë gjë e bukur të mëresh me bletë", tha Aleksandra.

Përveç pasionit, dy të moshuarit sigurojnë edhe të ardhura nga shitja e produkteve të tyre, si mjalti dhe nënproduktet e tjera të bletës.



"Ne me këto bletë jemi mbajtur, përveç pensionit", tha ajo.

Ata kanë edhe një këshillë për brezin e ri, t'i përkushtohet më shumë këtij zanati, i cili jo vetëm ruan një traditë të hershme, por ofron edhe mundësi të mira për të ardhura dhe punë të ndershme.

Kina konfirmon tarifat ndaj produkteve të qumështit të BE-së pas hetimit

Kina ka konfirmuar se do të vendosë tarifa për një gamë të gjerë produktesh të qumështit të importuara nga Bashkimi Evropian, tha Ministria e Tregtisë në Pekin.

"Tarifat do të variojnë nga 7,4% në 11,7% në varësi të kompanisë dhe do të hyjnë në fuqi këtë të premte", tha ministria në një deklaratë.

Kjo do të thotë që Kina ka caktuar tarifa dukshëm më të ulëta se tarifat e përkohshme prej 21,9% deri në 42, 7% të vendosura në dhjetor.

"Tarifat do të zbatohen gjatë pesë viteve të ardhshme për lloje të caktuara të djathit të freskët dhe të përpunuar, si dhe qumështin dhe kremin e qumështit me përmbajtje më

të lartë yndyre, të cilat janë të destinuara kryesisht për konsum njerëzor", tha ministria.

Një listë e publikuar nga autoriteti tregon se kompanitë nga Gjermania, Franca, Belgjika, Holanda, Spanja dhe Italia janë të prekura.

Megjithatë, tarifat nuk ka



gjasa të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë tek konsumatorët në Evropë.

Ministria e Tregtisë e Kinës hetoi produktet për subvencione të dyshuara të padrejta që nga gushti i vitit 2024.

Një zëdhënës i Ministrisë Kineze të Tregtisë theksoi se hetimi ishte kryer në përputhje me parimet e drejtësisë, paanshmërisë dhe transparencës.

Ministria arriti në përfundimin se produktet e qumështit të BE-së ishin subvencionuar, gjë që kishte dëmtuar prodhuesit kinezë.

Hetimet e Pekinit shihen si një kundërmasë ndaj tarifave të Brukselit, të vendosura në nëntor 2024, ndaj automjeteve elektrike të prodhuara në Kinë.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA
LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Të aplikojmë teknologji efikase për kultivimin e misrit në kushtet e ndryshimeve klimatike

Prof.as. Dr. Kostandin Hajkolla, QTTB Shkodër

Farat janë baza e prodhimit bujqësor. Gjatë gjithë historisë së zhvillimit bujqësor, rritja e rendimentit dhe e cilësisë së produktit bujqësor kanë qenë dhe janë qëllimi kryesor. Ato janë mbështetur dhe realizuar me dy mënyra kryesore: së pari duke përmirësuar teknologjinë e kultivimit dhe së dyti përmes përzgjedhjes së kultivarëve më të përshtatshëm.

Megjithatë, sfidat me të cilat përballen bujqësia sot, ndryshimet klimatike, rritja e popullsisë, presioni për të zvogëluar përdorimin e pesticidëve dhe ruajtja e tokës, kërkojnë qasje më të shpejta dhe më të sakta për aplikimin e teknologjive më efikase dhe zhvillimin e varieteteve të reja.

Përmirësimi gjenetik tradicional i bimëve bazohet në përzgjedhjen dhe kryqëzimin e bimëve me tipare të dëshirueshme, të tilla si rendimenti, rezistenca ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve ose cilësia e produktit. Ky proces është plotësisht natyror dhe ka qenë e vetmja mënyrë për të përmirësuar varietetet e bimëve për dekada të tëra. Megjithatë, disavantazhi kryesor i përmirësimit tradicional është koha: duhen vite, madje dekada, për të prodhuar një varietet të ri të qëndrueshëm.

Në kushtet e ndryshimeve të shpejta klimatike dhe shfaqjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve të rinj, kjo qasje shpesh nuk mund t'u përgjigjet mjaf-tueshëm shpejt nevojave të fermerëve. Në shumicën e rasteve përmirësimi gjenetik klasik është bazuar në hibridizimin e varieteteve brenda gjinisë apo species, duke krijuar kultivarë apo hibride me rendiment më të lartë. Përfitimi i hibrideve përfaqëson një hap të madh përpara në bujqësinë moderne. Kryqëzimi i kontrolluar i linjave prindërore rezultojnë në pasardhës me karakteristika pozitive të theksuara: rendiment më të lartë, rritje uniforme dhe rezistencë më të mirë.

Për një prodhim të qëndrueshëm e të sigurtë, në kushtet e ndryshimeve klimatike, në vëmendjen e seleksionerëve të bimëve po kthehen debatet mbi kultivarët OMGJ (kultivarët bioteknologjike bazuar në organizmat e modifikuara gjenetikut). Në ndryshim nga OMGJ-të klasike, seleksionerët e bimëve në Evropë po mbështesin dhe aplikojnë teknikat nGT (new genome techniques). Teknikat bazë në nGT janë: Cisgenesis; Intragensis; Mutagenesis dhe Transgenesis. Aktualisht nuk ka asnjë produkt të marrë nga nGT dhe të tregtuar në BE. Ka disa produkte të tregtuara jashtë BE-së: një sojë me një profil më të shëndetshëm të acideve yndyrore; një domate e pasuruar me acid gama-aminobutirik; një bakter për plehërimin e tokës bujqësore. Disa produkte të reja janë në fazën e para-tregtimit ose në zhvillim e sipër. Parashikohet një ndryshim legjislativ nga BE dhe përfshirja në strukturat e mbjelljeve të produkteve nGT gjatë vitit 2026.

Elemente të dukshme të ndryshimeve klimatike

Temperatura e rritur. Pritet që temperatura mesatare vjetore të rritet çdo vit. Sipas parashikimeve, deri në vitin 2040, temperatura mesatare vjetore do të jetë 1,5° C më e lartë. Kjo mund të duket e parëndësishme, por kjo rritje do të ndryshojë kushtet e jetesës për të gjithë.

Efekt i serrë. Efekt i serrë është pasojë e një çekuilibrimi të energjisë (nxehtësisë) ndërmjet sasisë së nxehtësisë që Toka merr nga Dielli dhe sasisë që ajo çliron sërish në hapësirë. Ngrohja globale ndodh si rezultat i emetimeve të tepërta të gazeve serë (GS), si dioksidi i karbonit, metani, klorofluorokarburet, oksidet e azotit dhe të tjera që thithin rrezatimin diellor dhe mbajnë nxehtësinë.

Terreni i ndryshuar. Ndryshimet në terren janë shpesh rezultat i proceseve të erozionit, në një shkallë më të vogël ose më të madhe, duke i bërë shpesh këto zona të pakultivueshme për shkak të zhdukjes së shpateve të buta, krijimit të grykave, zhdukjes së lëndës organike të tokës, grumbullimit të aluvioneve të imëta ose të mëdha dhe zëvendësimit të tokës pjellore me material inerte.

Thatësira. Thatësira është një nga pasojat më të rëndësishme të ndryshimeve klimatike, duke shkaktuar zhdukjen e llojeve të shumta bimore dhe shtazore, si dhe migrimin e njerëzve. Çrregullimet në regjimin ujor të tokës bëjnë që toka të thahet, si një nga hapat e parë të shkretëtirimit. Si rezultat, toka bëhet e papërshtatshme për kultivimin e bimëve dhe mbijetesën e bimësisë në përgjithësi.

Fatkeqësitë e shpeshta. Përmbytjet – Rritja e sasisë së reshjeve brenda një intervale të shkurtër kohor po vërehet si një shkurtrë gjithnjë e më e zakonshme. Kushtet e tilla klimatike çojnë në përmbytje të rrëmbyeshme shkatërruese që mund të dëmtojnë banesat, infrastrukturën ekonomike dhe rrugore, tokat dhe prodhimet bujqësore në afërsi të rrjedhave ujore.

Po kështu **erozioni dhe rrëshqitjet e dheut** janë produkt i rritjes së shpeshtësisë së thatësirave, përmbytjeve dhe zjarreve në pyje që çojnë në degradim të relievit, duke rezultuar në rrëshqitje të dheut, zhdukjen e tokave pjellore dhe shkatërrimin e infrastrukturës ekzistuese në zonat e prekura nga këto dukuri.

Migrimi i popullsisë. Ndryshimet klimatike po krijojnë gjithnjë e më shumë kushte të patolerueshme jetese dhe pune, duke rezultuar në migrimin e popullsisë. Arsyeja

më e shpeshtë e migrimit është mungesa e kushteve elementare të jetesës, si uji i pijshëm dhe toka pjellore, por edhe dukuritë negative si rrëshqitjet e dheut etj. Deri në vitin 2050, është vlerësuar se 700 milionë deri në 1 miliard njerëz do të detyrohen të ndryshojnë vendbanimin e tyre për shkak të humbjes së tokës së punueshme dhe fatkeqësive që vijnë nga kushtet e ndryshuara klimatike.

Shkrija e akullnajave. Shkrija e akullnajave në kapakët polarë të rruzullit dhe malet e larta janë evidente dhe po shkaktojnë një rritje globale të nivelit të deteve. Me ndryshimet e nivelit të detit ndryshojnë edhe nivelet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe në përmbytje të zonave bregdetare.

Urbanizimi. Për shkak të kushteve të ndryshuara klimatike, kryesisht rritjes së temperaturës, intensitetit të reshjeve, periudhave të thata, si dhe me presionet në rritje të migrimit njerëzor, do të ndryshojë edhe mjedisi jetësor. Do të shkojmë gjithnjë e më shumë drejt urbanizimit, rritjes së frikshme të përqendrimit të popullsisë në qendra të mëdha urbane.

Të reja në aspektin kërkimor dhe teknologjik

Për shkak të ndryshimeve klimatike, thatësirave gjithnjë e më të stërzgjatura pikërisht në periudhën kur misri kalon fazat kritike të zhvillimit (lulëzim - mbushje kalliri), vëmendja është përqendruar në zgjedhjen e hibridit më të përshtatshëm për kushtet konkrete të kultivimit. Tashmë qendrat kërkimore dhe kompanitë e prodhimit të farave po i paraprijnë me krijimin e hibrideve gjithnjë e më tolerantë ndaj këtyre ndryshimeve duke garantuar qëndrueshmëri në rendiment dhe prodhim më cilësor.

Hulumtimet kërkimore eksperimentale për bimën e misrit në vitet e fundit janë përqendruar kryesisht në:

- përzgjedhjen e hibrideve për kushte të ndryshme agroekologjike, përshtatshmëria me ndryshimet klimatike (**Klimakontroll 3, Plus4-grain**, hibride me kohë sa më të shkurtër ndërmjet lulëzimit të xhufkës dhe kallirit)
- përzgjedhja e hibrideve në varësi të dendësisë së mbjelljes (**hibridet fix dhe flex**)
- studime mbi efektin e qarkullimeve bujqësore, vlerësimin e efektivitetit të plehërimit mineral dhe organik në prodhimtarinë e bimëve dhe ruajtjen e pjellorisë së tokës
- zhvillimin e sistemit të kultivimit të kulturave bujqësore bazuar në teknika të bujqësisë organike për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm duke shfrytëzuar resurset gje-

netike (agroturizmi)

- treguesit cilësorë të kokrrës dhe aftësia asimiluese e kategorive të ndryshme të kafshëve (rritje e koeficientit të asimilimit të vlerave ushqimore të drithrave nga kategori të ndryshme kafshësh)

Elementet më të rëndësishme teknologjike në kultivimin e misrit në përshtatje të ndryshimeve klimatike

a. Zgjedhja e hibridit, kriteret bazë:

- **Treguesit agroekologjike të zonës apo mikrozonës, të dhëna të sakta mbi ndryshimet klimatike, rezultate të testimit zonal të hibrideve dhe eksperiencës së fermerëve.**

- **Kapaciteti teknologjik, ku përfshihen sasia dhe cilësia e inputeve (plehërimi, mbrojtja e bimëve), mekanizimi, ujitja, ruajtja dhe tregu.**

Në vitet e fundit shumica e kompanive, krijuese dhe prodhuese të farave hibride të misrit synojnë hibridet e tipit **Klimakontroll3** dhe **Plus4grain**. Këto hibride kanë përparësi pasi janë më tolerantë ndaj thatësirës dhe temperaturave të larta. Karakteristikat e përmirësuar të këtyre hibrideve shfaqen në faza të ndryshme të rritjes të cilat janë:

1. Deri në fazën e lulëzimit: fuqi rritëse të madhe, duke ulur efektet negative të stresit nga temperaturat e ulëta (nënkupton mbjellje të hershme), duke intensifikuar dhe siguruar rritjen dhe zhvillimin e elementeve prodhues në kalli (numër optimal të rrështave, numër optimal të kokrrave në rresht).

2. Ne fazën e lulëzimit: Dalje e plotë e organeve të riprodhimit (xhufka dhe mustaqet), me diferencë të vogla në kohë duke siguruar pjalmim të sigurtë dhe pllenim të plotë të të gjitha vezoreve.

3. Pas lulëzimit: zënie dhe mbushje e stabilizuar e kokrrës, shoqëruar me tiparin "stay green" të bimës, tipar me ndikim pozitiv në rrjedhshmërinë normale të mbushjes së kokrrës edhe në kushtet e stresit të thatësirës.

Fara të hibrideve të misrit me logot "**Klimakontroll3**" dhe **Plus4Grain**" janë tashmë në tregun tonë të farave. Ato janë krijime dhe produkte të kompanive lider në prodhimin e farave si KWS, Pioneer, Dekalb, Limagrain etj.

Karakteristikat e hibrideve Flex dhe Fix.

Hibridet me kalli **flex** kanë aftësinë për të ruajtur madhësinë e kallirit dhe për të dhënë prodhim të mirë në dendësi më të ulëta mbjelljeje. Në përgjithësi nuk reflektojnë rritje të rendimentit në dendësi më të larta, perkundrazi i përkeqësojnë treguesit e prodhimit.

Hibridet e misrit me kalli

fix japin një rendiment në rritje dhe të qëndrueshëm, në një gamë të ndryshme dendësie bimësh në mbjellje. Këto hibride reflektojnë pak ndaj dendësisë së bimëve ndërsa ruajnë një madhësi të qëndrueshme të kallirit edhe në dendësi maksimale. Nuk tolerojnë mungesa në të ushqyer dhe thatësirën (**kërkojnë doza plehërimi të larta, ujitja është e domosdoshme**).

b. Afati i mbjelljes

Përcaktohet nga faktorët agroekologjikë të zonës dhe mikrozonës, tashmë në ndryshim (ndarjet, zonat dhe nënzonat agroekologjike përcaktohen nga reshjet, temperaturat, struktura e tokës etj). Aktualisht po mbjellim më herët në disa zona (Sarandë, Gjirokastrë, Dibër) dhe po përdoren hibride me cikël më të gjatë (Dibër, Kukës, Korçë). Shfrytëzimi maksimal i elementeve ekologjike lidhet me mbjellje të hershme të cilat garantojnë nëse:

- Kemi kullim të mirë të tokës
- Kalime sa më të pakta të mekanikës
- Përdorim të agregatëve bujqësorë të përshtatshëm.

c. Përdorimi i plehrave dhe pesticideve

Misri është bimë me kërkesa të larta për lëndë ushqyese. Treguesit agroekologjikë të tokës dhe çmimet e plehrave diktojnë strukturën dhe sistemin e plehërimit. Shpesh ndeshim zgjedhjet gabuara që rrisin koston dhe ulin efektivitetin e plehërimit. Për bimën e misrit rekomandohen plehtrat me përmbajtje të lartë të elementeve ushqyese si DAP për elementin Fosfor, ure për elementin Azot, sulfat potasi për elementin Potas. Sistemi bazë i plehërimit që rekomandohet për bimën e misrit:

- **Plehërimi para mbjelljes.** Plehtrat organike, Plehtrat fosforike dhe potasike, Plehërimi azotik (deri 1/2 e sasisë së përgjithshme)

- **Plehërimi në vegjetacion** Plehërim azotik 1 ose 2 duar. Kur janë mundësitë edhe plehërimi i lëngët organik.

Trajtimet e farave me biostimulante po zënë sipërfaqe gjithnjë e më të mëdha në Evropë. Ato stimulojnë kalimin e shpejtë të fazave të para të rritjes për bimën e misrit, për të shmangur temperaturat e larta dhe thatësirën në kohën e lulëzimit.

Përdorimi i herbicideve po bëhet domosdoshmëri dhe është i justifikuar pasi kemi infeksione të lartë nga barërat e këqija. Kjo për arsye të kultivimit të misrit si monokulturë dhe faktit se "fermeri" apo bujku "komshi" nuk kryen trajtime për barërat e këqija. Efektiv-

iteti përcaktohet në zgjedhjen e duhur të herbicideve, respektimi i dozës, afatit dhe kushteve të përdorimit.

Përparësi në teknologjinë e kultivimit kanë marrë masat për luftimin e dëmtuesve kryesorë si: krimbi tel, krimbi i murrmë, krimbi i misrit, së fundi edhe krimbi i rrënjëve të misrit. Ky i fundit është bërë problematik në disa zona intensive të kultivimit të misrit monokulturë. Luftimi tij me insekticide është me efektivitet të ulët dhe kosto të shtuar. **Mënyrë më e mirë është qarkullimi bujqësor.**

d. Sigurimi i numrit të bimëve

Janë elementi kryesor për të siguruar prodhimin e planifikuar. Ai përcaktohet mbi bazën e karakteristikave të hibrideve, kushteve të kultivimit dhe destinacionit të prodhimit. Hibridet me cikël më të hershëm pranojnë dendësi më të mëdha. Hibridet intensive, tipi fix, kërkojnë dhe pranojnë dendësi më të mëdha. Përdorimi i makinave mbjellëse me precision siguron numrin e duhur të bimëve dhe shpërdarje uniforme të tyre në njësinë e sipërfaqes duke ekonomizuar sasinë e farës dhe uniformitetin në rritje e zhvillim.

e. Ujitja

Kushtet klimatike të Shqipërisë diktojnë kultivim të misrit me ujitje të garantuar. Ndryshimet klimatike diktojnë jo vetëm përdorim të hibrideve sa më tolerantë ndaj thatësirës por edhe efikasë për çdo m³ ujë të konsumuar me ujitje. Fazat më kritike dhe kërkesat më të mëdha janë ato para lulëzimit deri në pjekjen qumësht-dyllë. Në kushtet e mungesës së rreshjeve apo rezervave ujore të pakta, duhet të zgjedhim hibridin e duhur, cikël më të shkurtër, mbjellje të hershme, shërbime (kultivime) "konservuese" të lagështirës.

f. Vjelja, ruajtja e prodhimit

Afati i korrjes përcaktohet nga lagështia në kokërr. Misri për kokërr rekomandohet të vilet pas pjekjes fiziologjike, kurse misri për silazh rekomandohet të korret në fazën e qumësht-dyllit. Mekanizimi i procesit të vjeljes varet nga mënyra e ruajtjes.

Misri për ruajtje në formë kalliri duhet të korret kur lagështia është nën 27 %.

Për ruajtje në formë kokrre, konform standartit me 15% lagështirë, korra mund të realizohet me kombajnë edhe kur lagështia mund të jetë mbi 15% por me kusht tharjen e menjëhershme pas vjeljes. Tharja pas korrjes ndikon në rritjen e koston. Nëse lagështia është mbi 15%, mundësohet zhvillimi i myqeve dhe sëmundjeve kërpudhore. Të ushqyerit e kafshëve me këto produkte është me pasojë të rrezikshme jo vetëm në shëndetin e kafshëve por edhe të njeriut, si konsumator fundor në vargun ushqimor.

INFORMACIONE

Paketa e Maleve, Demo: 25 bashki kanë përcaktuar zonat prioritare, mbi 300 aplikime

Ministri i Shtetit për Push-tetin Vendor, Ervin Demo, në mbledhjen e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, të zhvilluar në Pallatin e Brigadave, prezantoi raportin për fuqizimin e pushtetit vendor, që sipas tij përqendrohet në katër drejtime: në zhvillimin ekonomik, kapacitetet vendore, modernizimi i qeverisjes dhe

aktorë realë ekonomikë, besoj se do të marrë një formë që realisht do të sjellë ndryshime në territor”, tha Demo.

Gjatë fjalës së tij ministri foli edhe për kapacitetet vendore, ku u ndal tek nisma e Akademisë së Pushtetit Vendor.

“Kanë nisur trajnimet e para që janë fokusuar në sistemin parashkollor dhe po ashtu sa

dimeve specifike, në mënyrë që t’u japin zgjidhje këtyre problematikave dhe hapat që duhet të ndjekin bashkitë”, tha Demo.

Ministri nënvizoi se projekti kryesor është digjitalizimi i shërbimeve vendore. Ai bëri të ditur se janë ngritur grupet e punë dhe theksoi se do të rishikohen të gjitha shërbimet vendore.

“Nuk mundet të digjitalizojmë shërbime që në vetvete mund të jenë të organizuara, në mënyrë deri diku kaotike. Ne duhet t’i thjeshtojmë shërbimet dhe më pas nëpërmjet digjitalizimit të bëjmë të mundur aksesin e garantuar për qytetarët, uljen e kostos dhe rritjen e eficiencës në nivel vendor”, tha ai.

Sa i përket performancës në shërbime, Demo tha se gjatë këtij viti ka nisur puna për ndryshimin e metodologjisë së Grantit të Performancës dhe fokusimin e saj në shërbimet reale që ofrohen në territor.

“Jemi duke punuar edhe me ministri të tjera, kur flasim për vlerësimin e shërbimeve, siç mund të jetë menaxhimi i mbetjeve, duhet që garantin e performancës ta lidhim realisht me cilësinë e shërbimeve që qytetarët marrin në territor”, tha Demo.

Demo shtoi gjithashtu se procesi i integritimit do të sjellë sfida për bashkitë në vend dhe se duhet fuqizim i bashkive në territor.

I ndalur tek reforma territoriale, Demo nënvizoi se “produkti që presim nga reforma territoriale është një produkt që do t’i lehtësojë të gjitha këto sfida dhe të përgatisë bashkitë nesër që të adresojë jo thjesht sfidat që do të vijnë si rrjedhojë e procesit të integritimit, por sfidat që ka vetë territori”.

“Do të fillojmë në tur faktmbledhës në territor dhe jam i bindur se hapi i mëpashtëm do të jetë me vlerësimin e funksioneve të bashkisë. Analiza e detajuar mbi funksionet duhet të jetë absolutisht një nga elementët kryesorë që do të kemi në konsideratë, për të garantuar bashki të qëndrueshme për ata që janë sfida të Shqipërisë 2030”, tha ministri.

AIDA memorandum bashkëpunimi ekonomik me Lidhjen e Bizneseve të Kosovës

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Lidhja e Bizneseve të Kosovës nënshkruan në Tiranë një memorandum bashkëpunimi.

Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Laura Saro zhvilloi një takim me delegacionin nga Kosova, të përbërë nga përfaqësues të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës (LBK), organizatë që përfaqëson mbi 2800 biznese nga sektori kyç të ekonomisë.

Në takim ishin përfaqësues të rëndësishëm të sipërmarrjes kosovare.

Takimi u përqendrua në prezantimin e mundësive për partneritete ekonomike, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe diskutimin e iniciativave të përbashkëta, përfshirë orga-

nizimin e një Forumi të Përbashkët të Bizneseve të Shqipërisë dhe Kosovës.

rete me ndikim në zhvillimin ekonomik të dy vendeve.

Ky është një moment i



Në përfundim të takimit, palët firmosën një Memorandum Bashkëpunimi, duke formalizuar një kornizë bashkërendimi për iniciativa të ardhshme dhe projekte konk-

rëndësishëm për thellimin e marrëdhënieve ekonomike dhe në krijimin e një platforme të qëndrueshme bashkëpunimi mes komuniteteve të biznesit të Shqipërisë dhe Kosovës.



performanca e shërbimeve.

Për sa i përket zhvillimit ekonomik, Demo u ndal tek programi “Paketa e Maleve”, ku bëri të ditur se sot janë rreth 25 bashki që kanë përcaktuar zonat prioritare dhe se vetëm në këto zona tashmë janë mbi 300 aplikime reale që po trajtohen nga pushteti vendor për përfundimin e lejes së ndërtimit.

Demo theksoi më tej se “rreth 25 bashki të tjera janë në proces e sipër të përgatitjes së dokumentacionit, i cili do të kalojë më pas për miratimin e zonave prioritare”.

Ministri shprehu bindjen se “në muajt që do të kemi para do të kemi një hartë të plotësuar në të gjithë territorin dhe besoj se targeti që kemi vendosur për vitin 2026 që do të jenë 1000 aplikime të suksesshme do të realizohet”.

Demo nënvizoi më tej se koncepti i bashkive sipërmarrëse ka për qëllim kthimin e bashkive në aktorë ekonomikë realë.

“Iniciativa për bashkitë sipërmarrëse është duke u diskutuar thellësisht me disa prej bashkive në vend. Besoj se në muajt që do të kemi para ky koncept i ri sa i përket zhvillimit ekonomik lokal dhe kthimit të bashkive në

i përket procesit të menaxhimit të mbetjeve. Akademia është një iniciativë që garanton qëndrueshmërinë, sepse vetë bashkitë janë pjesë e kësaj iniciative, ku kanë përcaktuar se do të mbështesin financiarisht Akademinë e Pushtetit Vendor me 50% të financimit në tre vitet para dhe 50% është një zotim që qeveria shqiptare ka ndërmarrë për ta mbështetur”, tha Demo.

Demo u ndal edhe te policia bashkiake, ku nënvizoi se “ajo do të jetë në nivel vendor pjesë e bashkive. Drafti i rishikuar, i cili është shpërndarë dhe do të diskutohet me kryetarët e bashkive, do të jetë i qartë, se ajo ku po fokusohet Ministria e Brendshme është garantimi i standardeve kombëtare sa i përket trupës të policisë bashkiake”.

Demo foli gjithashtu edhe për partneritetet akademike me universitete për të adresuar problematika specifike në territor.

“Partneritete akademike vazhdojnë dhe do të konsolidohen më tej në vitin 2026. Kemi përfshirë universitete në vend, duke marrë në konsideratë disa specifika që ka territori dhe bashki me problematika më të thella. Universitetet do t’u vijnë në ndihmë sa u përket stu-

AKU dhe KEK tryezë teknike me prodhuesit e bukës dhe importuesit e miellit për sigurinë ushqimore

Me ftesë të Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në

sit” një tryezë teknike me prodhuesit e bukës, brumërave dhe

në tregun e përbashkët, duke shërbyer si një platformë profesionale për harmonizimin e praktikave të punës me standardet e Bashkimit Evropian.

Gjatë diskutimeve mbi zbatimin e ligjshmërisë, drejtoresha e përgjithshme e AKU-së, Blerina Gjylameti e vuri theksin te roli i institucionit si filtër garancie përmes forcimit të kapaciteteve në Pikat e Inspektimit Kufitar.

Ajo theksoi se bashkëpunimi i ngushtë me biznesin është rruga kryesore për të siguruar produkte ushqimore gjithnjë e më të sigurta për konsumatorët shqiptarë.

“Tryeza teknike synon konsolidimin e dialogut mes institucioneve shtetërore dhe sektorit privat dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të sigurisë ushqimore në Shqipëri”, u shpreh Gjylameti.



bashkëpunim me Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK) dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u zhvillua në “Shtëpinë e Bizne-

importuesit e miellit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore në vend.

Takimi u fokusua mbi format e reja të inspektimit, certifikimet dhe sfidat e integritimit

Kina kultivon më shumë tokë bujqësore me standarde të larta në vitin 2025 mes shtytjes së modernizimit

Kina krijoi më shumë toka bujqësore me standarde të larta, ndërsa përpjekjet për modernizimin e bujqësisë në vend vazhduan të bënin përparim të qëndrueshëm në vitin 2025, treguan të dhënat zyrtare, shkruan “Xinhua”.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe Çështjeve Rurale, Kina arriti ndërtimin dhe rinovimin e 75.68 milionë mu (5.05 milionë hektarë) tokë bujqësore me standarde të larta vitin e kaluar, duke e çuar sipërfaqen totale të tokës

bujqësore me standarde të larta në të gjithë vendin në mbi 1 miliard mu.

Toka bujqësore me standarde të larta i referohet tokës së kultivuar që zakonisht është e pajisur mirë me objekte dhe mund të sigurojë rendimente të qëndrueshme dhe të larta.

Ndër treguesit e progresit të modernizimit bujqësor në Kinë, përparimet shkencore-teknologjike spikatën, duke kontribuar më shumë se 64 për qind në prodhimin bujqësor




Foto nga VCG

në vitin 2025, ndërsa pjesa e tregut të varieteteve të farave të rritura në vend për bagëtinë dhe shpendët, produktet ujore dhe perimet tejkaloi përkatësisht 80 për qind, 86 për qind dhe 91 për qind, zbuluan të dhënat.

Shkalla e përgjithshme e mekanizimit për kultivimin, mbjelljen dhe korjen e të mbjellave arriti në 76.7 për qind vitin e kaluar.

Vlen të përmendet se numri i dronëve bujqësorë në përdorim ka tejkaluar 300.000

njësi, me sipërfaqen e tyre vjetore të operimit që ka tejkaluar 460 milionë mu, treguan të dhënat.

Konferenca Qendrore e Punës Rurale, e mbajtur në dhjetor 2025, theksoi se modernizimi bujqësor dhe rural ka një ndikim të madh në modernizimin kinez në tërësi, duke bërë thirrje për përpjekje për të çuar përpara zhvillimin me cilësi të lartë të tokës bujqësore me standarde të larta në zona dhe kategori të ndryshme.

BUJQËSI

Garancia sovrane për kreditimin e fermerëve u shfrytëzua vetëm në masën 12%

